

DEKLARATË E PARTNERËVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR PËR INTEGRIMIN E ROMËVE NË KUADËR TË PROCESIT TË ZGJERIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Ne, Kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ritheksojmë angazhimin tonë për integrimin e romëve në shoqëritë tona dhe premtojmë të forcojmë përpjekjet tona si pjesë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimit rajonal.

Me këtë dokument miratojmë **Deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të Procesit të Zgjerimit të BE-së** me anë të së cilës **ne angazhohemi të vazhdojmë dhe forcojmë përpjekjet për barazi të plotë dhe integrim të romëve**, veçanërisht përmes ndjekjes dhe zbatimit të Konkluzioneve të Përbashkëta të Seminareve Rome, **si në vazhdim:**

1. Zotohemi për arritjen e **objektivave** të mëposhtëm:

- a. **Punësimi:** Rritja e shkallës së punësimit të romëve në sektorin publik në shkallë proporcionale të pjesëmarrjes së romëve në popullatën e përgjithshme; Rritja e shkallës së punësimit të romëve në të paktën 25 përqind;
- b. **Strehimi:** Kudo që të jetë e mundur, të legalizohen të gjitha vendbanimet joformale ku jetojnë Romët; ose të sigurohet strehim i përhershëm, i denjë, përballueshëm dhe i dekretuar për romët që aktualisht jetojnë në vendbanime joformale që nuk mund të legalizohen për arsye të justifikuar;
- c. **Arsimi:** Rritja e regjistrimit dhe e shkallës së përfundimit në arsimin fillor tek romët në 90 përqind dhe shkalla e regjistrimit dhe përfundimit në arsimin e mesëm në 50 përqind;
- d. **Shëndeti:** Garantimi i mbulimit universal të sigurimit shëndetësor për romët të paktën 95 përqind ose në masën e barabartë me pjesën tjetër të popullatës;
- e. **Regjistrimi civil:** Sigurim që të gjithë romët të jenë regjistruar në regjistrat civilë.
- f. **Mosdiskriminimi:** Forcimi i strukturave të qeverisë për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe krijimit të një nën-ndarje specifike për mosdiskriminimin e romëve brenda organeve zyrtare të mosdiskriminimit për të proceduar ankesat nga romët, sigurimi për mbështetje ligjore për viktimat e pretenduara dhe për të identifikuar skemat e diskriminimit, përfshirë diskriminim institucional dhe të fshehur;

2. Marrim përsipër të **përdorim të dhënat e disponueshme** (përfshirë rezultatet e Anketës Rajonale të Romëve në Ballkanit Perëndimor 2017) për të formuar politika të bazuara në prova për integrimin e romëve, dhe **të angazhohemi për të krijuar një mekanizëm të duhur për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e politikave për romët**, përfshirë të dhëna të rëndësishme për të matur arritjet e objektivave të përcaktuara në këtë Deklaratë, duke caktuar zyrat e statistikave kombëtare si institucione përgjegjëse kryesore për mbledhjen e të dhënave në përputhje me programet e tyre;

3. Sigurimi **për të forcuar dhe mbështetur Pikat Kombëtare të Kontaktit për Romët** si një mekanizëm gjithëpërfshirës për koordinimin dhe zbatimin e objektivave të dakorduara në këtë Deklaratë dhe për sigurimin e sinergjive midis ministrive të linjës përgjegjëse për integrimin e romëve;

4. Të biem dakord për të zhvilluar, miratuar dhe zbatuar standardet rajonale **për buxhetimin publik në lidhje me integrimin e romëve** për politikën kryesore dhe të synuara, përdorimi dhe rritja e **buxhetimit publik**, si qendror ashtu edhe vendor, duke përfshirë komunitetet rome për të arritur objektivat e lartpërmendura, përdorimin e **fondeve në dispozicion të donatorëve**, përfshirë Instrumentin për Ndihmë e Para-Anëtarësimin, për të avancuar statusin e romëve;

5. Angazhimi për të krijuar **kanale dhe mekanizma zyrtarë për përfshirjen e përbashkët të qeverive lokale dhe komuniteteve rome** në formulimin e politikave, marrjen e vendimeve, zbatimin dhe monitorimin e përpjekjeve të ndërmarra për të arritur objektivat e kësaj deklarete.

Ne u bëjmë thirrje institucioneve të Bashkimit Evropian:

6. **Të vazhdojnë të mbështesin** përpjekjet e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për të arritur objektivat për integrimin e romëve të përcaktuara në këtë Deklaratë;

7. **Të lidhin objektivat e dakorduara** për integrimin e romëve të përcaktuara në këtë Deklaratë me treguesit kryesorë të performancës për të vlerësuar progresin brenda procesit të zgjerimit;

8. **Të sigurohen që nismat kryesore të zgjerimit të avancojnë situatën e romëve duke prezantuar tregues specifikë për romët për masat kryesore**, veçanërisht në kuadër të Nismës për Sundimin e Ligjit, dhe Iniciativën e Zhvillimit Social-Ekonomik me qëllim të parandalimit të efekteve anësore ose lënia e romëve pas pjesës tjetër të shoqërisë;

9. **Të parashikojnë një rol më të fortë të partnerëve të Ballkanit Perëndimor në politikën e Bashkimit Evropian pas vitit 2020**, mbi integrimin e romëve duke siguruar pjesëmarrjen e partnerëve të Ballkanit Perëndimor në proces me një status vëzhguesi në minimum;

Duke pasur parasysh pikat më sipër:

10. Ne i shprehim mirënjohjen Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për fillimin e këtij procesi;

11. Ne e mirëpresim ftesën e Qeverisë së Shqipërisë për të pritur një takim vijues ministror në vitin 2020 për të vlerësuar progresin e bërë në arritjen e objektivave dhe përparësive të përcaktuara në këtë Deklaratë.

Secila prej palëve do të vëzhgojë këtë Deklaratë deri në datën e bërjes shtet anëtar i Bashkimit Evropian.